

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA MAMUSHË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-22-9826-1-2-1
Nr i brendshëm	626-22-021-1-2-1

Lidhur me tenderin:

Titulli: **“Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”-Ritender**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

BAJRAM HA.GASHI B.I. Suharekë, 23000, SUHAREKË

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Dubravë, 23000, SUHAREKË

(Adresa)

23000

(Vendi) **Suharekë**

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Bajram Gashi

811038498

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bging2011@gmail.com

(Adresa elektronike)

05.12.2022

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

ëShëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Blerësi	KOMUNA E MAMUSHËS
Kodi/Numri	2022/626-22-8114-1-2-1/B10-0021902
Emërtimi	Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse
Lloji i dokumentit*	B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit
Lloji i kontratës	1 Furnizim
FPP	50000000-5 Shërbime riparimi, mirëmbajtjeje dhe instalimi
Lloji i procedurës	1 Procedurë e hapur
Vlera e parashikuar	50,500.00
Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje	07.09.2022 14:00
Data e njoftimit	15.09.2022
Data e dërgimit	14.09.2022
Ligji	LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS
Dorëzimi elektronik i ofertave	Po

Njoftimet të tjera në procedurën e njëjtën të prokurimit:

Lloji i dokumentit
B10 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit
B05 Njoftim për Kontrat

07.09.2022 15:17	B12 Proces verbali i hapjes së Tenderve-Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave.PDF
Hape:	
Shqip	
Dokumenti shtojca	
08.09.2022 09:59	B58 - NJOF. MBI VEN. E AUTORITETIT KONTRAKTUES -Mbeshtetja dhe riparimi i ndërtesave.PDF

Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE tË Tenderit (FTD)

Të dhënat e mëposhtme për punë që do të prokurohen do të plotësojnë, shtojnë, ose ndryshojnë dispozitat e Informatave për Tenderuesin. Kurdo që paraqitet ndonjë mospërputhje, këto dispozita do të mbizotërojnë mbi ato në Informata për Tenderuesit.

ëUdhëzimet për plotësimin e Fletës mbi të Dhënat e Tenderit janë shënuar me germa kursive për Nenet relevante të Informatave për Tenderuesit. Fshijini ato që nuk janë të nevojshme]

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesit
Përshkrimi i Nenit	Nr. i Nenit	
Fusha e tenderit	1.1	Autoriteti Kontraktues (AK) është: Emri i AK: KOMUNA E MAMUSHËS Adresa e AK: Rruga “Sahat Kulesi” nr. 44 Ndërtesa e Komunës së Mamushës <u>Qyteti: Mamushë</u> <u>Kodi Postar: 20540</u> Adresa Elektronike: http://kk.rks-gov.net/mamushe/ Personi Kontaktues: Gazmend Gashi E-mail: mamushaprokurimi@gmail.com Telefoni: 03820045211 Faks:
	1.2	Titulli i kontratës dhe numri identifikues i aktivitetit të prokurimit është: “Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”-Ritender 626-22-9826-1-2-1
	1.3	Data e dorëzimit të Njoftimit të Kontratës në KRPP: 16.09.2022 Versioni i plotë i njoftimit të kontratës të dërguar në KRPP mund të shkarkohet nga faqja elektronike e KRPP-së www.krpp.rks-gov.net .
	1.4	Tenderi duhet të dorëzohet në adresën e përmendur në 24.1 përveç nëse nuk është e përmendur në 24.1 në adresën e përmendur në 1.1
Qëllimi i Kontratës	2.1	<u>Qëllimi i kontratës është [furnizim], [instalim], [riparim] dhe [shërbim pas shitjes]</u> nga operatori ekonomik i mallrave vijuese: <u>[Shëno përshkrimin e përgjithshëm të furnizimit dhe të dhënat sasiore]:</u> Lënda e kësaj kontrate ka të bëjë me furnizimin e artikujve të ndryshëm sanitar për mirëmbajtjen e ndërtesave të Komunës së Mamushës, shkollave, Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe ndërtesës së zjarrfikësve. Kontrata në fjalë është kontratë kornizë me një operator ekonomik e cila do të lidhet për periudhën 36 mujore. Përmes kësaj kontrate do të furnizohemi me 165 artikuj të ndryshëm për mirëmbajtje dhe riparim të ndërtesave. Për më shumë informata referojuni specifikimeve teknike tek aneksi 1 të dosjes së tenderit.
	2.2	Qëllimi i Autoritetit Kontraktues është të lidhë një kontratë publike kornizë me një operator ekonomik . Prandaj urdhërat do të vendoset sa herë që të shfaqet nevoja
	2.3	Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 50000000-5

Ndarja ne Lote	2.4	Ndarja ne Lote: Po ☐ Jo ☒ <u>Nëse objekti i tenderit është i ndarë në pjesë (lote) shëno:</u> <u>Objekti i kontratës është i ndarë në 1 pjesë (lote). Tenderuesi mund të paraqesë tender për:</u> ☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët <u>Secila pjesë e lot-it është e shënuar në specifikacionet teknike , shih Aneksin 1.</u> Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është: <u>[Sheno kriteret objektive dhe jo-diskriminuese apo rregullat për shpërblimin e loteve të ndryshme, ku aplikimi për përzgjedhjen e kriterëve për shpërblim do të rezultonte në shpërblimin e një tenderuesi me më shumë lote se sa numri maksimal].</u>	
Vlera e parashikuar e kontratës	2.5	50,500.00 €.	
Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik me tenderin e tij duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për furnizimet (materialët) e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (Të plotësohet, nënshkruhet dhe vuloset aneksi nr. 2 i kësaj dosje të tenderit).	
Variantet	4.1	Variante autorizohen: Po ☐ Jo ☒ <u>[Nëse variantet janë të autorizuar, shëno:]</u> Tenderuesit janë të autorizuar që të dorëzojnë një tender duke propozuar një variant që përputhet me një variant të specifikimeve teknike. Tenderuesit duhet të dorëzojnë specifikimet teknike të variantes se ofruar. Specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga ndonjë variant janë të shënuara në specifikimet teknike të parashtruara në këtë dosje të tenderit, shih Aneksin 1.	
Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	5.1	Vendi i dërgesës është: Furnizimi dhe montimi i artikujve do të bëhet në Mamushë në objektet e Komunës, shkollave, QMF-s dhe zjarrfikësve.	
	5.2	Kushtet e dërgesës: DDP (detyrat e dërguara të paguara) Çmimi i ofertës suaj duhet të përfshijë të gjitha taksat, ngarkesat dhe obligimet e tjera të paguara në Kosovë apo në vendin e themelimit të O.E.	
	5.3	Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: në muaj 36 ose në ditë _____ ose fillim _____ përfundim _____	
	5.4	Dërgesat do të kryhet VETËM pas dhënies së "urdhër blerjes" që do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktues, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate publike afatgjate.	
	5.5	-Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë afatin e liferimit dhe të njejtin ta dorëzojnë me tenderin e tyre. -Afati i liferimit nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 (Pesë) ditë nga data e porosisë. -Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.	
<u>Kërkesat e përshtatshmërisë</u>	6.4	Përveç deklarates se shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet	

		Dokumentet te cilat do te kërkohe si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërisë janë me se vijon: - Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. - Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situatë e tillë nuk ekziston. - Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.	
		Kërkesat e përshtatshmërisë: 1) Deklarata nën betim se Operatori Ekonomik i plotëson kushtet në bazë të nenit 65 Paragrafi 65.1 pikat 1.1; 1.2; 1.3 të LPP-s për të gjitha pjesët 2) Operatori Ekonomik nuk duhet të jetë në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë pranë ndonjë Gjykate kompetente e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik. 3) Operatori ekonomik nuk duhet të jetë delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit.	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1) Deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe e vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 3 të dosjes së tenderit. 2) Një vërtetim apo certifikatë origjinale (ose kopje e noterizuar) i lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohe vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë. 3) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik. Vërtetimi kërkohe vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit deri ne

			datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë.	
		4) Operatori ekonomik duhet të ketë paguar tatimin në pronë në vendin e themelimit të biznesit së paku deri në periudhën e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.	4) Vërtetimi apo certifikata nga Komuna në të cilën është themeluar biznesi .Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet të jete me i vjetër se 60 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë.	
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale 1. Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin përkatës profesional, të bizneseve dhe ose të korporatave.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Kopja e Certifikatës së biznesit së bashku me pjesët informative të biznesit.	
		2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë deklarues të TVSH-së	2. Kopja e certifikatës së TVSH-së të lëshuar nga Organi Kompetent	
		3. Operatorë ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë regjistruar numrin fiskal në ATK apo në institucionin e ngjashëm kompetent.	3. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të numrit fiskal (nëse nuk është e përfshirë në certifikatën e biznesit).	
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar 1. Operatorët Ekonomik duhet të kenë një qarkullim financiar së paku 100,000.00 € në tri vitet e fundit.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Raportin,raportet apo vërtetimet përkatëse nga një ose më shumë banka ose deklaratat vjetore në ATK apo nga institucioni kompetent në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilat dëshmohet se O.E ka pasur një qarkullim financiar në tri vitet e fundit sipas kërkesës së lartshënuar.	
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte të natyrës së kontratës gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimumi 50,000.00 €.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Lista e projekteve të realizuara për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë punët e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me “Referencë” ose “Raport” për realizimin me sukses të Kontratës. (i) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të	

			këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës(transaksioni bankar fatura etj).	
		2. OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur ne projekt, minimumi 5 punëtor të rregullt ose me parakontratë me profile të ndryshme, nga të cilët minimumi një inxhinier i diplomuar ose bachelor i ndërtimtarisë me përvojë pune minimumi 3 vite.	2. Listën origjinale të punëtorëve të O.E. të nënshkruar dhe vulosur nga O.E. -Diplomat e inxhinierëve (kopje të noterizuar. Diplomat jashtë shtetit duhet të jenë të nostrifikuara) -Cv-të e inxhinierëve të nënshkruar nga inxhinieri (origjinal ose kopje te noterizuar)	
		3. 3.1 O.E. duhet të caktoj me vendim ose të autorizoj nga lista e stafit, menaxherin e kontratës për këtë projekt, i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar ose bachelor i ndërtimtarisë me përvojë pune minimumi 3 vite.	3. Autorizimi ose vendimi për caktimin e menaxherit të projektit (Origjinal ose Kopje e noterizuar) -Diploma e inxhinierit (kopje e noterizuar. Diplomat jashtë shtetit duhet të jenë të nostrifikuara) - Cv- e inxhinierit të nënshkruar nga inxhinieri (origjinal ose kopje te noterizuar)	
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. e. Të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të regjistruar në platformën elektronike të KRPP-s dhe tenderin duhet ta krijojnë dhe dorëzojnë përmes platformës në grup.		
Nënkontraktimet	12.1	a) një deklaratë ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe b) Të gjithë nenkontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.		

Siguria e tenderit	13.1	Shëno një nga opsionet: Po ☒ Jo ☐ Nëse kërkohet sigurimi i tenderit: Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit.	
	13.2	Shuma e Sigurimit të Tenderit duhet 1,000.00 € për periudhë valide prej [shëno kohëzgjatjen në ditë 90 apo muaj]	
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shëno një nga opsionet vijuese: Po ☒ Jo ☐ [Nëse kërkohet siguria e ekzekutimit] Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni, para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit.	
	14.2	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 5,050.00 € për periudhën prej 37 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës.	
Sqarimi i Dosjes së Tenderit	16.1	Shënim me rëndësi: Sqarimi i dosjes së tenderit dhe kërkesa për informata plotësuese do të bëhet deri me datën 30.09.2022 ora 14:00 Përgatitja - dorëzimi i ofertave (nga ana e OE) dhe pranimi i ofertave (nga ana e AK) do të bëhen vetëm në formë elektronike nëpërmjet platformës së prokurimit elektronik –ndësa dorëzimi i ofertave dhe aplikacioneve në formë fizike do të jetë i papranueshëm. Të gjithë O.E tenderin e tyre në formë elektronike duhet ti skanojnë dokumentet nga origjinali dhe ti bashkëngjisin kopjen e skanuar. Autoriteti Kontraktues nëse e sheh të nevojshme do të kërkojë nga O.E. që ta sjellë origjinalin e dokumenteve të kërkuara origjinal. Mos dorëzimi i dokumentit origjinal shpie në zbatimin e nenit 99.2 të LPP-s.	
Dokumentet që përbejnë Tenderin	19.1(h)	[nese eshte e aplikueshme, sheno kërkesat tjera]	
Valuta dhe Përshkrimi i Çmimit	20.2	Çmimi i ofruar nga Tenderuesi nuk do të jetë i ndryshueshëm. [Nëse çmimi do të jetë i ndryshueshëm] [Shëno metodën për ndryshim të çmimit]	
Krijimi i dokumenteve të përshtatshme të mallrave dhe shërbime të ngjashme	21.3	[shëno një nga opsionet vijuese] Nuk kërkohet nga tenderuesi të dorëzoj me tender listën e pjesëve rezervë [Nëse kërkohet lista e pjesëve rezerve] Tenderuesi duhet të dorëzoj me tenderin e tij listën e pjesëve rezervë të furnizimeve të përshkruar me specifikimet teknike, Aneksi 1].	
Periudha vlefshmërisë së tenderit	22.1	Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 60 ditë, ose muaj, ose deri në datën .	
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	24.1	Afati i fundit për dorëzim është: 10.10.2022 në 14:00:00 orë Vendi: Tenderët duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike përmes platformës elektronike të KRPP-s në adresën e AK-s.	
Afati kohor për dorëzimin është shkurtuar	24.2	Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar: Po ☐ Jo ☒ Nëse po, jep arsytim:	
Hapja e Tenderit	27.1	Hapja e tenderit do të bëhet me 10.10.2022 në 14:00:00 orë Vendi: Objekti i Komunës së Mamushës-Zyra e prokurimit nr. 17	

Kriteret e Dhënies	31.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët ☒ në bazë të poentimit: Pjesa A Funrizimi me artikuj nga pozicioni 1 deri 31 = 60% e pikëve në vlerësim Pjesa B Funrizimi me artikuj nga pozicioni 1 deri 38 = 30 % e pikëve në vlerësim Pjesa C Funrizimi me artikuj nga pozicioni 1 deri 90= 10 % e pikëve në vlerësim Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6 ☐	
Ankesat	32.3	Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin 1.1 të (FTD)	

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

e-prokurim

Jo

☐

Tenderin e kemi dorëzuar në mënyrë elektronike, përmes platformës. Hapja e çmimeve të ofertës është publikuar në e-prokurim pa ndonjë vërejtje të evidentuar.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

X në e-prokurim

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ne besojmë se AK, me kete rast ka shkelur disa nga dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve në vijim: Ligji nr. 04/L-042 Per Prokurim Publik ne Republiken e Kosoves; ndryshuar dhe plotesuar me ligjet 04/L-257; 05/L-068- dhe Ligjin nr. 05/L-092-Per Ndryshimin dhe Plotesimin e Ligjit

Pasi kemi parë Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, përmes “B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES” të datës 30.11.2022 me anë të së cilit jemi informuar se tenderi ynë është refuzuar. Atëherë ne kemi kërkuar qasje në tërë dokumentacionin relevant lidhur me ofertën në fjalë. Pas analizimit të dokumentacionit, përgjigjes nga ana juaj si AK, ne kemi vërjetur parregullsi të ndryshme të kryera nga AK me veprimet e tyre, të cilat përbëjnë shkelje të rënda të Ligjit për Prokurimin Publik dhe plotësimet e ndryshimet e tij dhe RrUOP.

Vendimi i jashtëligjshëm i AK, na ka dëmtuar neve si kompani. Për të dokumentuar se pretendimi ynë është i bazuar dhe se AK ka kryer shkelje të LPP, në vijim po i shkëpusim nenet ligjore në të cilat mbështet kërkesa jonë për rishqyrtim të vendimit në fjalë.

Janë shkelur këto nene të LPP: neni 1, neni 7 si dhe nenin 3, pika 4.1 dhe 4.4 te RrUOP.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Për të dokumentuar se pretendimi ynë është i bazuar dhe se AK ka kryer shkelje të LPP, në vijim po i shkëpusim nenet ligjore në të cilat mbështet kërkesa jonë për rishqyrtim të vendimit, tashmë jashtë ligjor të AK. Në vijim gjeni deklaratën tonë të qartë dhe të detajuar mbi faktet dhe argumentet të cilat, në të cilat mbështetet kërkesa jonë për rishqyrtim:

1. Neni 1 i LPP-së – Qëllimi

Përkatesisht, paragrafet 1, 2 dhe 3 te këtij neni. Pasiqë ne jemi kompania e përgjegjshme me çmimin më të lirë dhe padrejtësisht AK na ka mohuar të drejtën tonë legjitime që të jemi punëkryesit e këtij projekti, megjithë dokumentacionin dhe arsyetimin e ofruar në pyetjen tuaj për arsyetim të çmimeve. Prandaj ne kërkojmë që vendimi i datës 30.11.2022 të kthehet në rishqyrtim sepse është i kundërligjshëm, AK me këtë vendim ka nxjerrë standarde të dyfishta në mënyrën sesi i janë qasur dokumentacionit shtesë të paraqitur nga ana jonë me kërkesë të tyre (AK), andaj një qasje e tillë përveç se është joprofesionale është po aq edhe e kundërligjshme.

2. Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;

Ne nuk jemi trajtuar te barabarte dhe jemi diskriminuar nga AK, te cilet në mënyrë të pa bazë dhe joligjore, përkundër dëshmive të ofruara nga ne, kanë vendosur të refuzojnë ofertën tonë edhe pse ne jemi kompania e përgjegjshme me çmimin më të lirë. Përveç kësaj ne jemi më të lirët në shumë pozicione krahasuar me ofertat e pjesëmarrësve të tjerë në këtë proces tenderimi. Kjo nënkupton që çmimet e vendosura nga ne janë çmime të diktuar nga tregu dhe asgjë me tepër, ne jemi siguruar që të ofertojmë në mënyrë dinjitoze duke ofruar fillimisht cilësi të materialve me të cilat punohet dhe kualitet të shërbimeve dhe natyrisht duke menduar edhe për fitimin tonë, i cili bazuar në ofertat e pranuar nga furnitorët tanë, dokumentacionet e së cilave ua kemi dërgu sipas kërkesës tuaj, do na siguronin një fitim mjaft modest d.m.th jo shumë të lartë. Këtu do bëjmë një sqarim më të detajuar, pasi që vendimi juaj i pa bazë na ka bërë të ndjehemi totalisht të diskriminuar, veprim i cili është i kundërligjshëm sipas dispozitave të LPP neni 7. Ju lutem gjeni në vijim rrjedhën e ngjarjes, nga momenti kur AK ka kërkuar informacion shtesë për çmimet e vendosura nga ne me pretendimin se ato janë më të larta sesa çmimet e tregut, pastaj do

përfshijmë pjesë nga përgjigja jonë në këtë kërkesë

- Më 8.11.22 AK ka kërkuar sqarim për këto pozicione, po shkëpusim nga kërkesa B47

Andaj, kërkojmë që të na dërgoni informatat në lidhje me pozicionet e më poshtme të cilat i kemi ndarë në çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Pjesa A. Pozicionet: 9, 20, 27 dhe 29.

Pjesa B. Pozicioni: 9, 28 dhe 37.

Pjesa C. Pozicionet: 9, 11, 13, 25, 49, 51, 66, 70, 77, 78, 79, 81, 83, 84, 86 dhe 90.

Ne jemi përgjigjur në këtë kërkesë, duke argumentuar dhe arsyetuar se çmimet e ofruara nga ne janë plotësisht të diktuar nga tregu, pasi që po jetojmë në një periudhë kohe ku inflacioni ka goditur çdo sektor. Ndërtimi, është i goditur nga inflacioni në shumë sfera duke filluar nga derivatet, fuqia punëtore, materialet e ndryshme, furnitorët të cilët po ashtu ndikohen nga furnitorët e tyre dhe çmimet kështu barten prej njërit te tjetri. Këto janë forca të cilat nuk ndikohen nga ne, as nuk kontrollohen e as nuk mund të elimohen nga ne. Na është dashur thjeshtë të përshtatemi në mënyrë që të mos punojmë me humbje pasi që jemi kompani private. Lidhur me projektin në fjalë ne kemi ofertuar me çmimin për një sasi dhe për pozicionet për të cilat AK ka kërkuar sqarim ne kemi **ofruar sqarim dhe dëshmi**. Ne kemi ofruar dëshmi duke treguar prejardhjen e çmimeve të vendosura nga ne duke prezantuar **ofertat/ faturat e bashkëpunëtorëve/ furnitorëve tanë**. Këto dëshmi, shumica janë pranuar nga AK, por vetëm njëra nuk është pranar flasim për ofertën për ngrohje qendrore, dëshmi të cilën ua kemi dërguar së bashku me të tjerat, por që duket se nuk është marrë parasysh aspak. Po i shkëpusim këtu me radhë pozicionet nga oferta të cilën ne kemi marrë nga bashkëpunëtori ynë NNP B-Engineering, për këtë pozicion të cilën të plotë e gjeni të ngarkuar në e prokurim dt 10.11.22, për të cilat **AK në njoftimin B58 të datës 30.11.2022 pretendon se MUNGOJNË**, shihni të shkëputur nga përgjigja e tyre dhënë në njoftimin përmes B58:

çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut. Me datë 10.11.2022 O.E. i është përgjigjur kërkesës për sqarim, mirëpo për 4 artikuj (artikujt: 49, 51, 66 dhe 70) nuk ka dhënë ndonjë sqarim në lidhje me ekonominë e procesit të shërbimeve, çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicionin e O.E. për ekzekutimin e projektit, si dhe nuk ka dhënë informata shtesë mbi koston e shërbimeve të propozuara.

Por një gjë e tillë, siç është pretenduar nga AK nuk qendron aspak dhe ne kemi dëshmi për këtë, e gjeni në vjim, pozicionet janë shkeputur nga oferta që ne kemi marrë nga bashkëpunëtori ynë NNP B-Engineering (mund t'ua ridergojme ofertën e plote të cilën e kemi dërguar me pare me 10.11.2022, por ketu po shkëpusim vetem pozicionet për të cilat AK ka folur shkeputur si me larte nga përgjigja e tyre në B58.

Për pozicionin 70, për të cilin AK pretendon se nuk ekziston:

45	Furnizimi dhe demolimi i telekomandës me rreze infra të kuqe për komandim të klimës	1,00	35,00
----	---	------	-------

Për pozicionin 66, për të cilin AK pretendon se nuk ekziston:

71	Demontimi i radiatorëve trupave ngrohës me të gjithë pjesët mbajtëse dhe gypin furnizues. Kjo nënkupton largimin me kujdes të tyre, si dhe sanimin e dëmtimeve eventuale gjatë demontimit, cilat do qofshin ato (të gjitha këto duhet të kthehen në gjendjen e mëparshme).	1,00	75,00
----	---	------	-------

Për pozicionin 51, për të cilin AK pretendon se nuk ekziston:

20	Furnizimi dhe demolimi dhe montimi i ventilatorit aksial n = 900 rr/min, P = 300 W me rregullim	1,00	320,00
----	---	------	--------

Për pozicionin 49, për të cilin AK pretendon se nuk ekziston:

18	Ventilatori për largimin e ajrit në kaldatore i montuar në dritare Q = 800 m³/h, P = 250 W	1,00	260,00
----	--	------	--------

Andaj duke pasë të gjitha këto dëshmi ne shohim se AK na ka diskriminuar dhe në mënyrë të jashtëligjshme ka mohuar faktet. Më lartë kemi cekur se ne jemi operatori ekonomik i përgjegjshëm me çmimin më të lirë, por edhe nëse krahasohen çmimet tona me çmimet e ofruar të disa operatorëve të tjerë ekonomik pjesëmarrës në këtë tender, edhe pse janë shpallur të papërgjegjshëm nga AK, për mungesë të dokumentacioneve të tjera, por ne jemi koncentruar në çmimet me të cilat ata kanë ofertuar dhe kemi parë që çmimet e tyre janë të ngjashme me çmimet e ofruara nga ne, madje në shumë pozicione janë edhe më të larta. Këtu po shkëpusim pozicionet në fjalë të dy operatorëve ekonomike të cilët si total kanë ofertën e ngjashme me ne:

Oferta nga NPTSH LIMIT, për pozicionet në fjalë, po i shkëpusim sa për t'i krahasuar çmimet:

Pocizioni 70

70	Furnizimi dhe demolimi i telekomandës me reze infra të kuqe për komandim të klimës	copë	1.00	30.00
----	--	------	------	-------

Pocizioni 66

66	Demontimi i radiatorëve trupave ngrohës me të gjithë pjesët mbajtëse dhe gypin furnizues. Kjo nënkupton largimin me kujdes të tyre, si dhe sanimin e dëmtimeve eventuale gjatë demontimit, cilat do qofshin ato (të gjitha këto duhet te kthehen ne gjendjen e meparshme).	copë	1.00	35.00
----	---	------	------	-------

Pocizioni 51

51	Furnizimi dhe demolimi dhe montimi i ventilatorit aksial n = 900 rr/min, P = 300 W me rregullim	copë	1.00	320.00
----	---	------	------	--------

Pocizioni 49

49	Ventilatori për largimin e ajrit në kaldatore i montuar në dritare Q = 800 m³/h, P = 250 W	copë	1.00	300.00
----	--	------	------	--------

Oferta nga AAB construction, për pozicionet në fjalë, po i shkëpusim sa për t'i krahasuar çmimet:

Pocizioni 49

49	Ventilatori për largimin e ajrit në kaldatore i montuar në dritare Q = 800 m³/h, P = 250 W	copë	1.00	550.00
----	--	------	------	--------

Pocizioni 51

51	Furnizimi dhe demolimi dhe montimi i ventilatorit aksial n = 900 rr/min, P = 300 W me rregullim	copë	1.00	550.00
----	---	------	------	--------

Pocizioni 66

66	Demontimi i radiatorëve trupave ngrohës me të gjithë pjesët mbajtëse dhe gypin furnizues. Kjo nënkupton largimin me kujdes të tyre, si dhe sanimin e dëmtimeve eventuale gjatë demontimit, cilat do qofshin ato (të gjitha këto duhet te kthehen ne gjendjen e meparshme).	copë	1.00	80.00
----	---	------	------	-------

Pocizioni 70

70	Furnizimi dhe demolimi i telekomandës me reze infra të kuqe për komandim të klimës	copë	1.00	20.00
----	--	------	------	-------

Pra, marrë si mesatare çmimet e ofertuara janë pasqyrim i gjendjes së tregut dhe nuk ka asgjë të jashtëzakonshme në të aspekt. Në një kohë kur në shumë sfera ekonomike çmimet janë dyfishuar, natyrisht se nuk mund të izolohet sektori i ndërtimit, edhe ne jemi bartës të këtyre çmimeve dhe nuk ka rrugë tjetër. Por pa marrë parasysh kushtet ekonomike me apo pa inflacion RESPEKTIMI I LIGJIT ËSHTË KUSHT I DOMOSDOSHËM QË DUHET TË RESPEKTOHET NGA TË GJITHË! E ju si AK me këtë vendim keni bërë shkelje të rëndë ligjore, ne kërkojmë që ky vendim të rishqyrtohet!

3. Pika 4.1 dhe 4.4 RrUOP.

Me shkeljen e dispozitave të lartëcekura të LPP-së, AK ka bërë shkelje të rëndë edhe të parimeve dhe rregullave të sjelljes që përshkruhen në RrUOP, në pikat 4.1 dhe 4.4 ku thuhet:

“4.1 AK gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim në mesin e Operatorëve Ekonomik.” Kështu duke mos marrë për bazë faktet e ofruara nga ne, AK ka shkelur këtë pikë si dhe disa nga parimet e vendosura nën pikën 4.4 të RrUOP, të cilën e shkëpusim në vijim:

“Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim: Konkurrenca – në mesin e furnizuesve duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive; Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për parën për AK; Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për furnizuesit ose furnizuesit potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial; Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga furnizuesi ose furnizuesi potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit; Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente; Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.”

Duke konsideruar shkeljet e rënda të cekura më lartë ne kërkojmë që AK ta kthejë procedurën në Rivlerësim dhe ta shpallë kompaninë tonë fituese të këtij tenderi, në përputhje të plotë me LPP, pasi që jemi kompania e vetme e përgjegjshme dhe me çmimin më të lirë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demi material i shkaktuar është rreth 5,000.00 EURO, duke përfshirë këtu pagatitjet teknike të ofertes dhe kërkesës për rishqyrtim, duke konsideruar faktorin kohe dhe faktorin njeri.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*